



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1165/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Ronit Abdullahut anetare i AKR-se dega ne Ferizaj, konkretisht kandidat per asamble komunale te Komunes se Ferizajit paraqitur kunder Komisionit Qendror te Zgjedhjeve (KQZ) pas shpalljes se rezultateve perfundimtare per kuvend komunal për shkak të parregullsive gjate procesit zgjedhor dhe Manipulimit te votave , në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Ronit Abdullahut kandidat per kuvendin komunal te Ferizajit nga rradhet e AKR-se dega ne Ferizaj.

Arsyetim

PZAP-i, më datë 03.12.2013 ka pranuar një ankesë nga Ronit Abdullahu anetare e subjektit politik te AKR-se, konkretisht kandidate per asamble komunale te Komunes se Ferizajit icili pretendon ne manipulim te votave ne qendren e votimit 2501X-Pjeter Bogdani-2507D/01R/02/03/04/05R-fsh Greme-2508/01R/02R/03R-Gaqke-2528/01R/02R-fsh Bibaj si dhe votat me kusht ne qendren e votimit 2503D Ahmet Hoxha,2525D-fsh Zaskok,2511-fsh Sojeve,2512-fsh Dardani,2534-fsh Zillatar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi se nga deshmitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës si dhe nga pretendimet e ankuesit në ankesën e tij se ka ndodhur manipulimi i votave gjate procesit Zgjedhor , vlerësohen si te pabazuara dhe të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindëse, siç pretendon pala ankuese në ankesën e saj, andaj ankesa e tillë është e pabazuar dhe se për këtë çështje PZAP-i në mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së,si dhe dhe nenit 3.6.pika c. vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 1165/2013 më datën 06.12.2013



Këshillë Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*